



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2022

**Prishtinë, qershor 2023**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 MMPHI gjatë vitit kishte realizuar pagesa në vlerë 286,436€ nga kategori ekonomike jo adekuate.
- B2 MMPHI kishte realizuar pagesa në vlerë 313,899€ për 64 të punësuar me Marrëveshje të Brukselit të cilët nuk kanë objektiva të punës, nuk janë të sistemuar dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në ministri.
- C1 Vlera e pasurisë e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë si rezultat i mos-regjistrimit të pesë pagesave për projekte kapitale në vlerë 4,972,315€, regjistrimit të gabuar të disa pasurive jo kapitale në SIMFK në vlerë 291,025€ si dhe mos-regjistrimit të shtatë pagesave në vlerë 184,940€ për blerje të pasurive jo kapitale në sistemin E-pasuria.
- B3 Si rezultat i mos-aplikimit të zhvlerësimit për projekte të përfunduara, mos-bartjes së pronësisë së projekteve të bashkë-financuara për komuna si dhe mos-regjistrimit të drejtë të pasurive në SIMFK, gjendja e pasurisë ishte e mbivlerësuar për 3,027,494€ si dhe e nënvlerësuar për 51,368,968€.
- C2 Vlera e obligimeve në PVF ishte mbivlerësuar për 319,261€ si rezultat i paraqitjes së shpenzimit si obligim i papaguar.
- B4 Detyrimet kontingjente të prezantuara në PFV për vitin 2022, ishin mbivlerësuar për 3,036,432€ derisa në anën tjetër ishin nënvlerësuar për 1,614,323€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Kontrata publike për mirëmbajtje është përdorur për zgjerim të rrugës në vlerë 96,409€.
- B5 Ministria përkundër rregullave ka aplikuar pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%) për kontrata me çmim për njësi. Kjo ka rezultuar me tejkalim të vlerës së kontratës për 1,369,651€.
- C3 Në një projekt ishin bërë ndryshime në sasi të realizuara në raport me paramasën e kontraktuar pa aprovime paraprake dhe si rezultat kishte tejkalim të realizimit të sasive të kontraktuara në vlerë 114,055€ (pa u tejkaluar vlera e kontratës).
- B6 Në 29 raste të pagesave nuk ishin zbatuar hapat për procedim të pagesave siç kërkohet me rregulloren e aplikueshme.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat e klasifikuara të nivelit konfidencial nga ana e Ministrisë nuk janë audituar dhe nuk janë pjesë e këtij raporti.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të

përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më tepër fokus janë çështjet me ndikim në opinionin financiar që kryesisht lidhen me një paraqitje jo të saktë të shpalosjeve përkatësisht gjendjes së pasurisë, obligimeve dhe detyrimeve kontigjente. Sa i përket fushës së shpenzimeve mbetet sfiduese kompensimi i të punësuarve sipas Marrëveshjes së Brukselit të cilët nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në ministri. Vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet edhe keqklasifikimit të shpenzimeve.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të kontratave për mirëmbajtje të rrugëve duke evituar tejkalimet e vlerave të lejuara të shpenzimit si dhe ndryshimit të kushteve kontraktuale. Veprime shtesë janë të domosdoshme edhe në menaxhimin dhe implementimin e projekteve kapitale ku mangësitë në hartimin e projekteve dhe vonesat në realizimin e tyre vazhdojnë të jenë shumë të theksuara.

Në kontekst të pagesave, duhet parandaluar shpenzimet përmes vendimeve gjyqësore që masivisht kanë të bëjnë me konteste të shpronësimit, të cilat në vazhdimësi po i shkaktojnë ministrisë kosto shtesë për kamatë dhe shpenzime gjyqësore. Masa konkrete duhet të merren edhe tek menaxhimi më i mirë llogarive të arkëtueshme, përkatësisht të sigurohen mekanizma efikas për vlerësim dhe arkëtim të borxheve që i kontribuojnë rritjes së të hyrave.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 20 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja, 14 rekomandime të përsëritura dhe tre (3) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Lidhur me këtë nga mostrat e testuara kemi identifikuar se:

- Pagesa për “Furnizim me kontejner” në vlerë 190,027€, ishte realizuar nga kategoria e Investimeve kapitale edhe pse për nga natyra furnizimi i takon kategorisë mallra dhe shërbime (çmimi për njësi për kontejner ishte 15.83€), dhe
- Pagesa për “Zgjerimin e rrugës për një shirit qarkullimi në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak” në vlerë prej 96,409€, ishte realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së investimeve kapitale.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate.

#### Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata jo të sakta për lexuesit e PFV. Po ashtu ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive ekonomike jo adekuate për këto shpenzime.

#### Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ri-destinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë

#### Gjetja

Sipas nenit 8 të rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik“. Po ashtu, neni 43.2 i Ligjit nr. 06/L – 114 për zyrtar publik thekson që “Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njesisë apo institucionit”.

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për



normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për integrimin e personelit nga ish e ashtuquajtura “Mbrojta Civile”. Në kuadër të kësaj marrëveshje për integrim, në MMPHI përmes akt-emërimeve janë të punësuar 64 punonjës të komunitetit serb të cilët marrin paga të rregullta. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës, nuk kanë objektiva të përcaktuara dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2022 ishte 313,899€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezentë ndër vite edhe pse në vazhdimësi po raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmer masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

**Ndikimi** Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmime për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e këtyre të punësuarve duke siguruar kushte pune, duke përcaktuar objektiva të qarta të punës si dhe të siguroj monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C1 - Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël**

**Gjetja** Neni 6.3 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Ne kemi identifikuar disa mangësi sa i përket regjistrimit të pasurive, të cilat kanë ndikuar në mos-prezantimin e drejtë të gjendjes së pasurisë në PFV. Mangësitë e identifikuar përfshijnë:

- Mos regjistrimin e pesë (5) pagesave<sup>5</sup> në vlerë 4,972,315€ në regjistrin SIMFK për projekte të ndryshme kapitale të realizuara në vitin 2022 të cilat kanë shkaktuar nënvlerësim të gjendjes reale të pasurisë;

- Ne regjistrin SIMFK ishin regjistruar gabimisht tre (3) pagesa të blerjes së pasurive jo kapitale (nën 1,000€) duke e mbivlerësuar regjistrin për vlerën neto të pasurisë për 291,025€; si dhe

- Gjashtë (6) pagesa për blerjen e “Pajisjeve të IT-së” në vlerë 165,069€ si dhe një (1) pagesë për blerje të mobilieve në vlerë 19,871€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria duke shkaktuar nënvlerësim të gjendjes së pasurisë në vlerë të përbashkët prej 184,940€.

Vlen të theksohet, se bazuar në rekomandimin e vitit paraprak, ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) kishte bërë largimin nga regjistri SIMFK të pagesave të regjistruara ndër vite për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në vlerë

71,801,641€.

Mangësitë e identifikuar në prezantimin e drejtë të gjendjes së pasurisë kanë ardhur si rezultat i pakujdesisë dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

**Ndikimi** Mos-regjistrimi i plotë dhe regjistrimi i gabuar i pasurisë ka ndikuar që vlera e pasurive e prezantuar në PFV të mos jetë e saktë.

**Rekomandimi C1** Ministri duhet të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm në fushën e pasurisë për të siguruar prezantim të plotë dhe të drejtë të gjendjes së pasurisë së institucionit në pajtim me kërkesat ligjore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Prezantim jo i drejtë i gjendjes së pasurisë si rezultat i mbajtjes së pasurisë si investim në vijim dhe mos bartjes së pronësisë tek komunat përkatëse**

**Gjetja** Neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Po ashtu neni 13 i kësaj rregulloreje përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj".

Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimit e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës përkatëse.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Ministria vazhdon t'i mbajë si investime në vijim pesë (5) projekte kapitale<sup>6</sup> në vlerë totale 9,730,362€, të cilat kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i tyre. Si rezultat i regjistrimit të tyre në klasën joadekuatë dhe mos aplikimit të zhvlerësimit, pasuria ishte e mbivlerësuar në efektin neto për 1,260,316€.

Vlen të theksohet, projekti "Autostrada R6 Prishtinë – Hani i Elezit" i përfunduar në shtator të vitit 2019 figuron ende si investim në vijim në SIMFK si dhe nuk është bërë regjistrimi i plotë i të gjitha pagesave. Sipas të dhënave të ofruara nga Ministria vlera totale e pagesave për këtë projekt ishte 705,313,524€, ndërsa në regjistrin e pasurisë në SIMFK nuk ishin regjistruar pagesa në vlerë 140,113,541€. Si rrjedhojë vlera neto e këtij projekti është e nënvlerësuar në SIMFK për 50,710,301€ (duke përfshirë

edhe efektin e zhvlerësimit).

- Po ashtu, ministria vazhdon ti mbajë në regjistër të pasurive katër (4) projekte të përfunduara<sup>5</sup> për komuna dhe të pranuar teknikisht në vlerë 1,608,395€ duke mos bartur pronësinë në komunat përkatëse. Si rezultat pasuria e ministrisë është e mbivlerësuar për vlerën e këtyre projekteve.

Më tutje, neni 6 i Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, parasheh se: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël”. Po ashtu, neni 22 thekson se: “Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit”. Ky nen i rregullores përcakton edhe normat e zhvlerësimit për secilin kategori të pasurive.

Lidhur me këtë kemi identifikuar:

- Transferi kapital në vlerë 3,800,000€ për KRU “Hidrodrini” Sh.A – Pejë që është dashur të regjistrohej si “Investim në vijim”, ishte regjistruar në kategorinë “Kanalizimi” duke shkaktuar nënvlerësim të pasurisë neto për 658,667€ si pasojë e aplikimit të zhvlerësimit;

- Po ashtu, në regjistrin e pasurive në SIMFK, katër (4) pagesa të regjistruara në vitin 2006 “Rehabilitimi i rrugëve Kamenicë Tushec” ishin regjistruar në klasën e pasurive “Struktura tjera” ku norma e zhvlerësimit është 40 vite dhe jo në klasën “Ndërtimi i Rrugëve” me normë të zhvlerësimit 20 vite, siç përcaktohet me rregulloren e pasurive. Si rezultat vlera e pasurisë është e mbivlerësuar për 158,783€. Këto gabime në regjistrime janë identifikuar edhe në vitet paraprake por ministria nuk kishte ndërmarrë masa për korrigjimin e tyre.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive.

#### **Ndikimi**

Mbajtja e pasurive kapitale si investime në vijim, përkundër faktit që ato plotësonin kriterin për tu klasifikuar si pasuri në përdorim, mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat përfituese, si dhe regjistrimi i pasurive në klasa të gabuara ndikon në mos-paraqitjen e drejtë të gjendjes së pasurisë.

#### **Rekomandimi B3**

Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C2 - Shpalosja jo e drejtë e obligimeve të papaguara në PFV**

#### **Gjetja**

Sipas, Nenit 17 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

“Organizatrat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues”. Vlera e obligimeve në PVF nuk ishte prezantuar saktë.

Vlera e obligimeve në PVF nuk ishte prezantuar saktë. Ne identifikuar se në totalin e obligimeve ishte përfshirë edhe pagesa për rehabilitim të rrugëve rajonale në vlerë 319,261€ e cila ishte paguar në dhjetor të vitit 2022.

Kjo ka ndodhur shkak i pagesës në fund vit dhe si rezultat i mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në evidentimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara.

- Ndikimi** Kontrollet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve kanë ndikuar në shpalosje jo të drejtë të obligimeve në PFV.
- Rekomandimi C2** Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të pa-paguara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV**

- Gjetja** Sipas nenit 18 të Rregullores nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, “Organizatrat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente”.

Detyrimet kontingjente të shpalosura nga ministria kryesisht kanë të bëjnë me konteste gjyqësore për shpronësime. Prandaj, për prezantimin e vlerës së tyre në PFV, ministria për vitin 2022 ka përdorur metodën e supozuar duke llogaritur rreth 50% të vlerës së vlerësuar sipas vendimit përfundimtar të Qeverisë për shpronësimet.

Ne identifikuar se detyrimet kontingjente të prezantuara në PFV nuk ishin të sakta si rezultat i mangësive në vijim:

-Në nëntë (9) raste vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e ulët se vlera e prezantuar në PFV duke mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 3,036,432€; si dhe

-Në dy (2) raste vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e lartë se vlera e prezantuar në PFV dhe kjo ka rezultuar me nënvlerësim të vlerës së detyrimeve kontingjente për 1,614,323€.

Krahas tyre, duhet thekuar se për 11 mostra të testuara me vlerë të përbashkët 2,237,677€ nuk kemi arritur të vlerësojmë vlerën e prezantuar në PFV, pasi dëshmitë ishin të pakompletuara.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së zyrtarëve të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe mangësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontingjente në PFV.

**Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherësh ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

**Rekomandimi B4** Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Ndryshim i kushteve kontraktuale pas skadimit të kontratës

#### Gjetja

Neni 61.20 (pika g) i A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), thekson se funksionet e menaxherit të projektit janë: Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, si dhe neni 61.25 përcakton se ndryshimi i kontratës për sasi të shtesë të artikujve të njëjtë do të përdor çmimet e njëjta apo më të ulëta për njësi si në kontratën fillestare. Për pozicionet të cilat nuk ka çmime në kontratën fillestare AK duhet të zbatohet nenin 35.3 të LPP-se.<sup>7</sup>

Kontrata publike për “Mirëmbajtjen verore dhe dimërore 2021-2022 të rrugëve Nationale dhe Rajonale – Regjioni Mitrovica LOT 2”, në vlerë 574,015€ (aneks kontrata në vlerë 54,634€) kishte skaduar me datë 15.07.2022. Pas skadimit të kontratës me datë 16.08.2022, ministria me operatorin e njëjtë ka aprovuar një Urdhër-variacion duke ndryshuar termat dhe kushtet e kontratës. Ky ndryshim ka të bëjë me zgjatjen e afatit të kontratës për 30 ditë, si dhe zëvendësimin e 34 pozicioneve të pashfrytëzuara nga kontrata fillestare në vlerë 97,972€ me nëntë (9) pozicione të reja të cilat nuk kanë të bëjnë fare me shërbimin e njëjtë por kanë të bëjnë me zgjerimin e rrugës për një shirit qarkullimi. Për këto pozicione nuk ka pasur çmime të përcaktuara në kontratën fillestare. Ministria ka vepruar në mos-përputhje me nenin 35.3 të LPP-së duke mos-aplikuar procedurën e duhur për kryerjen e punës. Vlera e realizuar për zgjerimin e rrugës ishte 96,409€.

Mos aplikimi i procedurave të duhura të prokurimit dhe shfrytëzimi i kontratës pas afatit të skadimit ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të kontrolleve duke e përdorur si arsye kryerjen e kësaj pune me emergjencë.

#### Ndikimi

Realizimi dhe pranimi i punëve pa procedurën e duhur të ndryshimit të kontratës mund të shkaktojë shpenzime më të larta se çmimi përkatës i tregut dhe kualitet jo të mirë të punës.

#### Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë që çdo shpenzim të jetë i mbështetur në kontratën përkatëse, po ashtu të sigurojë që zhvillohen procedurat e duhura të prokurimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B5 - Tejkallim i pagesave për kontratat me çmim për njësi

#### Gjetja

Neni 56.15 i A01 RrUOPP, përcakton se kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus

tridhjetë përqind (30%).

Në dy raste kemi identifikuar se ministria ka përdorur kontratat publike kornizë me çmim për njësi dhe përkundër rregullave ka aplikuar pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%). Kjo ka rezultuar me tejkalim të vlerës së këtyre kontratave për 1,369,651€ (në vlerë të përbashkët).

- Kontrata për "Mirëmbajtje rutinore dhe dimërore e Auto Udhës A6 (Arbër Xhaferi)-Segmenti: Konjuh - Doganaj, L-32.82km" është nënshkruar me 11.03.2019 me çmim për njësi 200€. Si pasojë e aplikimit të pragut apo tavanit plus/minus tridhjetë përqind (30%), vlera e kontratës për tre vite është tejkaluar për 724,375€.
- Kontrata për "Mirëmbajtje rutinore dhe dimërore e Auto Udhës A6 (Arbër Xhaferi)-Segmenti: Doganaj - Hani i Elezit, L-20.07km" është nënshkruar me 05.06.2019 me çmim për njësi 81.24€. Si pasojë e aplikimit të pragut apo tavanit plus/minus tridhjetë përqind (30%), vlera e kontratës për tri vite është tejkaluar për 645,276€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve lidhur me pajtueshmërinë ligjore gjatë realizimit të kontratave me çmim për njësi.

#### **Ndikimi**

Mos-respektimi i dispozitave ligjore sipas llojit të kontratave ndikon në tejkalim të shpenzimeve dhe njëkohësisht sjellë vështirësi në realizimin e projekteve tjera të ministrisë.

#### **Rekomandimi B5**

Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës kontrolle të duhura në respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht kushteve të pagesave të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktual.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C3 - Ndryshime në sasi të paramasës pa aprovim paraprak**

#### **Gjetja**

Neni 61.22 dhe 61.23 të Rregullave dhe UOPP theksojnë se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Për kontratën "Ndërtimi i Autoudhës A7.1- Dheu i Bardhë-Udhëkryqi Bresic Loti 1" në vlerë 18,468,427€, kemi identifikuar se kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara në tre pozicione të kontratës në vlerë 114,055€, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar por pa rritur çmimin total të kontratës. Këto ndryshime ishin bërë pa aprovim paraprak nga ZKA dhe pa njoftim të Departamentit të Infrastrukturës Rrugore.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e mos-planifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe mos-funksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me mbikëqyrjen e këtyre projekteve.

#### **Ndikimi**

Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar në mungesë të aprovimeve të duhura rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë në pajtim



me kërkesat e projektit dhe mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar.

**Rekomandimi C3** Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkojnë pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Mangësi në procedimin e pagesave**

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01/2013 Shpenzimi i parave publike - fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-blerja, pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 29 pagesa kemi identifikuar se në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe ishte lëshuar urdhër-blerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të procedurave për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Pranimi i faturave para zotimit të mjeteve dhe urdhër-blerjes, mund të ndikoj në rritjen e obligimeve për periudhat e ardhshme në rast të pamundësisë së kryerjes së pagesës nga ana e ministrisë. Kjo mund të rezultojë edhe me padi nga ana e operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi B6** Ministri duhet të vendos kontrolle të shtuara financiare dhe të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me përpikëri të gjitha procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen sipas rregullave të përcaktuara ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe meditje për vitin 2022 ishte 4,012,130€ ndërsa deri në fund të vitit ishin shpenzuar 3,618,297€ apo 90% e buxhetit final. Numri i buxhetuar i të punësuarve ishte 622 ndërsa në fund të vitit numri aktual i të punësuarve ishte 547.

#### **Çështja A2 - Mos hartimi i rregulloreve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës pas ndryshimeve strukturore të ministrisë**

**Gjetja** Neni 10.2 i “Rregullores (QRK) nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura” specifikon se në rast të ndryshimit të strukturës organizative institucionet janë të obliguara t’i ndryshojnë “Rregulloret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës”.

Në mars të vitit 2021 struktura organizative e ministrisë ka pësuar ndryshime me hyrjen në fuqi të “Rregullores (qrk) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive” me të cilën është themeluar “Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës” (MMPHI) si rezultat i bashkimit të ish “Ministrisë së Infrastrukturës” me ish “Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”.

Edhe përkundër ndryshimeve strukturore që ka pësuar kjo ministri, ende nuk janë hartuar rregulloret e reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Si rezultat, shumë pozita udhëheqëse janë të dyfishuara dhe vazhdojnë të operojnë me përgjegjësi të ndara si para ri-strukturimit të ministrisë (Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit, Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore, Drejtori i Departamentit Ligjor etj.).

Për pozitën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm dhe Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) me vendim të Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm është caktuar nga një person përgjegjës në kuadër të ministrisë. Ndërsa, dy të punësuarit tjerë me akt-emërime ekuivalente, edhe pse i janë marrë autorizimet që lidhen me detyrën, nuk janë ri-sistemuar. Si rezultat, për pozitën e theksuara, vazhdojnë të kompensohen nga dy zyrtar.

Kjo ka ndodhur në mungesë të veprimeve konkrete të ministrisë për hartimin e rregulloreve të reja për ri-organizim të stafit në përputhje me ndryshimet strukturore që kanë ndodhur.

**Ndikimi** Mos-hartimi i rregulloreve të reja për ri-organizim dhe sistemim të stafit sipas kërkesave ligjore, shkakton shpenzime të dyfishta për pozitë të njëjtë të punës.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të siguroj se do të ndërmerren masa drejt hartimit dhe harmonizimit të të gjitha rregulloreve në përputhje me ndryshimet strukturore të ministrisë në mënyrë që të evitohen pozitat dhe shpenzimet e dyfishta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 190,912,612€, prej tyre ishin shpenzuar 105,715,097€ apo 55%. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me ndërtime dhe shtresëzime të rrugëve, pagesa për shpronësime të tokave, bashkëfinancime të projekteve bazuar në Memorandumet me komunitat, rregullime të lumenjve etj.

### Çështja A3 - Dobësi në projektin "Sanimi i rrëshqitjes së rrugës në hyrje të Autostradës nga rruga Nationale N2 në Mazgit"

**Gjetja** Neni 8.4 i rregullores nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB përcakton që: Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në pajtim me kontratën apo urdhër blerjen. Tutje sipas neni 8.7 të kontratës "Obligimet e kontraktuesit" përcakton se: Kontraktuesi do të sigurojë për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale për realizimin e punëve të kontraktuara.

Për projektin "Sanimi i rrëshqitjes së rrugës në hyrje të Autostradës nga rruga Nationale N2 në Mazgit" me vlerë 269,996€ sipas kontratës së datës 18.02.2022, gjatë vlerësimit të pagesave të realizuara dhe ekzaminimit fizik, kemi vërejtur se edhe pse ishin realizuar rreth 83% të pagesave për këtë projekt, rruga ishte dëmtuar, përkatësisht kishte plasaritje të asfaltit të rindërtuar.

Sipas informatave të siguruar nga ministria dhe nga ekzaminimi fizik ende nuk janë konstatuar shkaqet përfundimtare të këtij dëmi dhe përmirësimet nuk kanë ndodhur.

**Ndikimi** Mos sanimi i dëmtimeve nga ministria rezulton me shpenzime të paarsyeshme duke mos përmbushur qëllimin e kontratës si dhe rrezikon dëmtimin e mëtutjeshëm të rrugës.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të siguroj se janë identifikuar shkaqet e dëmit të ndodhur si dhe në përputhje me kushtet e parapara të kontratës, të zbatohen dispozitat lidhur me përgjegjësinë e defekteve. Po ashtu, të sigurohet se pranimi i punëve bëhet bazuar në cilësinë e materialeve dhe punës profesionale të OE, në të kundërtën të aplikohet sigurimi i ekzekutimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B7 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

**Gjetja** Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë. Po ashtu, edhe neni 40.1 thekson "Kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik

ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrin ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë”.

Pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore në kategorinë e investimeve kapitale në vitin 2022 ishin 4,299,626€ dhe në përgjithësi kanë të bëjnë me pagesën e shpronësimeve. Në tre (3) raste të testuara të këtyre pagesave në vlerë 477,644€, ministria përveç borxhit kryesor në vlerë 341,689€ kishte paguar shpenzime shtesë për kamatë dhe procedura gjyqësore në vlerë 135,950€.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i ankesave të shumta ndër vite të palëve të pakënaqura me vlerësimin e pronave në vendimin përfundimtar të shpronësimit, vlerësim ky i kryer nga Departamenti i Tatimit në Pronë, ish Ministria e Financave.

#### **Ndikimi**

Kjo situatë ka rezultuar me rritjen e kostos së ministrisë duke krijuar vështirësi në realizimin e projekteve të aprovuara për vitin përkatës/vijues.

#### **Rekomandimi B7**

Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B8 - Vonesa në realizimin e projekteve**

##### **Gjetja**

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet ministrisë dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në shtatë (7) raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuara janë:

-Kontrata “Ndërtimi i Tranzitit në Malishevë “ loti 1, në vlerë 959,026€ ishte nënshkruar me datë 14.06.2019. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte 04.07.2019, dhe përfundimi për 180 ditë pune. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2022, përkatësisht për më shumë se tre vite ishte 125,589€, apo 13% e vlerës së kontraktuar.

-Kontrata “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R-108, Segmenti II” në vlerë 3,789,533€ ishte nënshkruar me datën 09.07.2019. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte 28.07.2019, dhe përfundimi për 705 ditë pune ose rreth 25 muaj (aneks kontrata me datën 23.09.2021 në vlerë 378,593€ me afat për 120 ditë pune). Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2022, përkatësisht për më shumë se tre vite ishte 2,771,478€ apo 66% e vlerës së kontraktuar.

- Kontrata “Ndërtimi i Autoudhës A7.1- Dheu i Bardhë-Udhëkryqi Bresic Loti 1” në vlerë 18,468,427€ ishte nënshkruar me datën 13.02.2018. Sipas nenit 7 të kontratës, afati kohor i përfundimit të punimeve është 30 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Lidhur me këtë projekt ishte nënshkruar edhe një aneks kontratë me datën 14.06.2019 në vlerë 1,843,392€ me afat 60 ditë për realizim të punëve. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit

2022 ishte 13,413,652€ apo 73%.

- Kontrata “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve sinjalizuese ndriçuese, numëruesve Automatik Radar si dhe i pajisjeve radar vetëdijësues” në vlerë 302,674€ ishte nënshkruar me datë 08.08.2022. Sipas nenit 6.4 të kontratës, data e fillimit të punëve ishte 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe realizimi i punëve maksimum 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Vlera e punëve të realizuara deri në përfundim të auditimit, ishte 57,650€ apo 19%. Arsyet e mos-realizimit me kohë ishin vonesat në liferimin e produkteve nga prodhuesi tek OE.

- Kontrata “Ndërtimi i Urës në rrugën Nacionale N9, segmenti Pejë – Kuqishtë” në vlerë 390,254€ ishte nënshkruar me datën 14.04.2022. Sipas kontratës afati i përfundimit të punëve ishte 130 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës, sipas planit dinamik. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2022, ishte 61,585€ apo 16%.

- Kontrata “Renovimi i objektit të Departamentit për menaxhim të rrugëve DMRR” në vlerë 155,277€ ishte nënshkruar me datën 23.09.2022. Sipas kontratës afati i përfundimit të punëve ishte 3 muaj. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2022, ishte 65,228€ apo 42%. Për këtë projekt kemi bërë edhe ekzaminim fizik dhe deri në periudhën 15.05.2023 renovimet në objekt nuk kishin përfunduar.

- Kontrata “Asfaltimi i Rrugës lokale nga kryqëzimi N25 - Grejkoc -Rrafshi Livadheve” kontrata në vlerë 2,980,445€ ishte nënshkruar me datën 06.05.2020 (aneks kontrata me vlerë 297,248€ me datën 03.12.2021), dhe realizimi i punëve ishte për 15 muaj. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2022 ishte 954,039€ apo 29% e vlerës së kontraktuar.

Vonesat e theksuara në projekte janë pasojë e problemeve me shpronësimin e tokave, elaborati i pakompletuar i shpronësimit, gabimet në projektin ekzekutiv, projektet gjatë realizimit të punëve kanë rezultuar se nuk përshtaten me gjendjen e terrenit, mungesa e mjeteve buxhetore, inflacioni etj.

#### **Ndikimi**

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që ministria të mos arrijë objektivat e përcaktuara, vështirësi në qarkullimin e qytetarëve në rrugët e caktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

#### **Rekomandimi B8**

Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B9 - Mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive për ndërtim të rrugëve**

#### **Gjetja**

Gjetja Neni 8.4 i rregullores nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB përcakton që: Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e

pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në pajtim me kontratën apo urdhër blerjen. Sipas kontratave projektuesi duhet të hartojë projektin ideor dhe kryesor me elaboratet dhe projektet përcjellëse, ku projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet e largpërçuesve, rrjetin e telefonisë, të ujësjellësit dhe instalimet tjera etj.

Kontrata “Ndërtimi i Auto udhës A7.1- Kryqëzimi me disnivel A6 A7.1 (Banullë) - Dheu i Bardhë- pjesa Kryqëzimi në disnivel A6 A7.1 (Banullë) – dhe kryqi “Bresalc”- L=22.31 km, Lot 6” në vlerë 11,633,267€ e nënshkruar me datë 15.02.2018, është plotësuar me aneks kontratë për punë shtesë në vlerë 1,138,818€ (me datë 06.04.2022), për dy (2) pozicione të reja të paparashikuara në projekt, për të cilat me aneks është aprovuar sasia dhe çmimi i ri.

Komisioni i emëruar për shqyrtimin dhe vlerësimin për punë shtesë kishte konstatuar mangësitë e projektit të hartuar, përkatësisht në këtë projekt nuk ishte përcaktuar saktë kategoria apo lloji i tokës ku do të ndërtohet rruga, si gërmimi i dheut i kategorisë VII, si dhe pozicioni spërkatja me emulzion. Si pasojë e gabimeve në projektim është ndërprerë puna për një periudhë të caktuar duke shkaktuar edhe kosto shtesë rrjedhimisht nevojën për lidhjen e një aneks kontrate. Kompania projektuese pjesërisht kishte pranuar gabimet/devijimet në projekt.

Sipas ministrisë kjo ka ndodhur pasi që kompania projektuese kishte dorëzuar projektet duke mos përfillur kërkesat e përgjithshme të parametrave të terrenit ku do të realizohet projekti, ndërsa komisioni i pranimit nuk ishte siguruar se projektet përmbushin të gjitha kushtet për pranim.

#### **Ndikimi**

Hartimi i projekteve jo në pajtueshmëri me kërkesat teknike, rezulton me mos ndërtimin e rrugëve në afatet e parapara me kontratë, pamundëson planifikimin e vlerës reale të investimeve, rrit nevojën e kërkesave për punë shtesë që në fazën e inicimit të punimeve duke shkaktuar kosto dhe procedura shtesë për përfundimin e projekteve.

#### **Rekomandimi B9**

Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në teren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MMPHI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B10 - Pagesat për shpronësime**

#### **Gjetja**

Neni 16.2 i Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme përcakton “Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i prituri – nëse ka të këtillë – që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 2.2.



interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimin Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.

Në 13 raste të testuara në vlerë 2,917,555€, kishte vonesa në pagesën e shpronësimeve prej 5 muaj deri në 33 muaj pas aplikimit nga ana e palëve për përfitim të mjeteve. Edhe përkundër vonesave ministria në asnjë rast nuk kishte aplikuar interesin në shkallë prej 7% ashtu siç parashihet me ligj.

Vonesat në pagesa kishin ndodhur kryesisht në mungesë të buxhetit ndërsa mos-aplikimi i interesit prej 7% në pagesa ka ndodhur për shkak të disa paqartësive ligjore që ka ministria lidhur me këtë çështje.

**Ndikimi** Mos-aplikimi i interesit në pagesat e shpronësimit është në kundërshtim me ligjin dhe dëmton përfituesit, respektivisht pronarët e tokave të shpronësuara.

**Rekomandimi B10** Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.

## **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja B11 - Mos funksionalizimi i "Sistemit Elektronik të Shpronësimit"**

**Gjetja** Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/78 të datës 09.03.2016 obligohen të gjitha institucionet Shtetërore dhe Publike, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për përdorimin e Sistemit Elektronik të Shpronësimit (SESH) të krijuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke futur të dhënat e punës së tyre gjatë procesit të shpronësimit, vlerësimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, institucionet tjera shtetërore dhe publike të cilat janë të përfshira në procesin e shpronësimit, të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205.

Për ta menaxhuar më lehtë çështjen e shpronësimeve, MMPH-ja është në proces e sipër të vendosjes së (SESH) që nga viti 2013, mirëpo ky sistem ende nuk është funksionalizuar dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vazhdon të kryhet në mënyrë manuale në programin Excel. Data-baza ku ruhen të dhënat e pagesave të ekzekutuara ndër vite për shpronësimet, mbahet në formatin Excel, gjë që paraqet rrezik të lartë që shënimet të humbasin ndryshohen apo të manipulohen, duke mos lënë gjurmë. Gjatë vitit 2022 ministria kishte ndërmarrë disa masa në këtë drejtim duke formuar një grup punues për ndërmarrjen e veprimeve ligjore dhe teknike për funksionalizimin dhe avancimin e Softuerit si dhe koordinimin e punëve me të gjitha institucionet përkatëse të përfshira në këtë proces. Po ashtu ishte formuar edhe një grup punues teknik me ekspert të fushës së IT-së për të bërë analizën teknike të SESH. Megjithatë edhe këtë vit sistemi nuk

ka arritur të funksionalizohet dhe nuk është në përdorim.

Sipas zyrtarëve përgjegjës të ministrisë në këtë proces janë të përfshira edhe institucione tjera shtetërore dhe kërkohet bashkëpunim ndërinstytucional për tu funksionalizuar sistemi. Po ashtu për shkak të kompleksitetit të sistemit kërkohet edhe sigurim i kapaciteteve njerëzore, profesionale e teknike.

**Ndikimi**

Mos funksionalizimi i SESh-it dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vetëm në Excel, si dhe mungesa e një procedure për të funksionalizuar plotësisht këtë proces, rrit rrezikun e gabimeve dhe cenon sigurinë e të dhënave.

**Rekomandimi B11**

Ministri duhet të siguroj monitorim të vazhdueshëm të mekanizmave të krijuara për ecurinë e këtij procesi dhe në bashkëpunim me institucionet e përfshira të punojnë në drejtim të funksionalizimit të këtij sistemi dhe aplikimit të tij nga të gjitha institucionet.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 2.3.3 Të arkëtueshmet

MMPHI në PFV e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,099,461€. Këto kanë të bëjnë me obligime të pa-arkëtuara të kompanive shfrytëzuese të ujit, faturime për pompa të karburanteve, transport të jashtëzakonshëm, hyrje-daljet e objekteve afariste etj.

#### Çështja B12 - Mos ndërmarrja e veprimeve për inkasim të borxheve

##### Gjetja

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ 1/2014 mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale përcakton se "Tarifat për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, shfrytëzimin e tokës e cila jepet me qira dhe vendosje të objekteve të përkohshme, bëhet sipas tarifave të përcaktuara". Më tutje neni 6 - Dispozitat kalimtare parasheh që me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ Ministria do ti modifikoj të gjitha kontratat për shfrytëzimin e tokës të cilat i takojnë rrugëve Nacionale dhe Rajonale brenda afatit prej gjashtë (6) muaj.

Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me shfrytëzuesit e pronave publike përcaktohen afatet e inkasimit të të arkëtueshmeve.

Në pesë (5) raste të testimit të llogarive të arkëtueshme në vlerë të përbashkët prej 281,338€, ne kemi identifikuar që Ministria kishte faturuar kontraktuesit ndër vite por nuk kishte arkëtuar asnjë borxh. Kontratat për shfrytëzimin e brezit rrugor në tri raste ishin lidhur në vitin 1999 dhe 2000, në një rast në vitin 2007 dhe në një rast në vitin 2011, ndërsa operatorët e kontraktuar nuk kishin kryer pagesa që nga kontraktimi.

Për më tepër me hyrjen në fuqi të UA 1/2014 në vitin 2014, Ministria kishte faturuar kontraktuesit me tarifat e reja por nuk kishte ndërmarrë masa për t'i modifikuar kontratat e tyre sipas afatit ligjor të përcaktuar në udhëzuesin e ri administrativ.

Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitet paraprake të auditimit. Sipas dokumenteve të ofruara, ministria kishte tentuar në disa raste t'i arkëtoj borxhet përmes procedurave përmbartimore dhe gjykatës por si rezultat i kontratave dhe borxheve të vjetërsuara, faturave të pa-nënshkruara nga pranuesit nuk është arritur të arkëtohet borxhi.

##### Ndikimi

Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave.

##### Rekomandimi B12

Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B13 - Mos marrja e veprimeve ndaj shfrytëzuesve të ujit pa leje ujore****Gjetja**

Ligji nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës neni 97, parasheh në hollësi veprimet dhe kompetencat që duhet të ndërmarrë Inspektorit i ujërave në rastet kur identifikon kryerje të aktiviteteve pa leje ujore apo në kundërshtim me lejen. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat, ndërsa me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre.

Nga regjistri i pranuar prej ministrisë për gjendjen deri në fund të vitit 2022 për shfrytëzuesit e ujit, janë raportuar rreth 38 kompani shfrytëzuese të ujit, të cilëve ju ka skaduar leja ujore dhe nuk iu është vazhduar më për shkak të mos shlyerjes së borxheve të akumuluar. Nga të dhënat e raportuara 19 prej këtyre kompanive janë ambalazhues të cilëve kryesisht ju ka skaduar leja ujore në periudhat 2013-2016. Këta shfrytëzues vazhdojnë të shfrytëzojnë ujin pa leje ujore dhe pa e kryer obligimin financiar. Inspektorati i ujërave as gjatë vitit 2022 nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre në bazë të kompetencave që i takojnë edhe pse kjo çështje është ngritur edhe në raportet e auditimit të viteve paraprake.

Kjo ka ndodhur në mungesë të ndërmarrjes së veprimeve nga ministria për evitim të kësaj dukurie dhe për shkak të pa-qartësisë së vendimeve të Qeverisë për faljen dhe lehtësimin e borxheve në rastin e Operatorëve Ekonomik që ambalazhojnë ujin.

**Ndikimi**

Mungesa e veprimeve të nevojshme për parandalimin dhe rregullimin e dukurive të tilla ndikon në shfrytëzimin e pa kontrolluar të ujit, në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe të hyrave, si dhe në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

**Rekomandimi B13**

Ministri të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me komizën ligjore në fuqi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njesisë së Auditimit (NjAB). Si rezultat i ndryshimeve strukturore të ministrisë, në korrik të vitit 2022 Ministri merr vendim për krijimin e një njësie të përbashkët, si Divizion i Auditimit të Brendshëm i MMPHI, për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë administrative. Përgjegjës i NjAB është caktuar Udhëheqësi i ish MMPH, dhe kjo njësi operon me 5 auditor (drejtor dhe 4 auditor). NjAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit. Nga tetë (8) auditime të planifikuara ka realizuar pesë (5) auditime, si dhe katër (4) auditime me kërkesë nga menaxhmenti. Periudha e mbulimit të raporteve përfshinë 43% të periudhës aktuale. Këto raporte kanë rezultuar me 53 rekomandime, prej të cilave, rekomandime të zbatuara ishin 27, në proces 12 dhe të pa zbatuara 14.

#### Çështja B14 - Komiteti i auditimit jo funksional

##### Gjetja

Neni 4.1 i UA MF-NR. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik përcakton se çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Ministria në tetor të vitit 2022 ka shfuqizuar vendimin për themelimin e Komitetit të Auditimit, pasi nuk kishte mbajtur asnjë takim dhe nuk ishte funksional siç kërkohet me udhëzimin relevant. Përderisa, nuk ka ndërmarre ende hapat për themelimin e një komiteti të ri të auditimit.

Kjo situatë është rezultat i mungesës së veprimeve të ndërmarra nga ministria për themelimin të komitetit të ri ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore.

##### Ndikimi

Një situatë e tillë zbeh ndikimin e proceseve të kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe pamundëson mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe marrëdhënies së tij me menaxhmentin në drejtim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.

##### Rekomandimi B14

Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>a</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>237,013,729</b>	<b>220,051,155</b>	<b>127,999,741</b>	<b>143,815,760</b>	<b>92,170,794</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	171,233,729	153,779,993	113,850,439	137,304,739	63,943,147
Financimi përmes huamarrjes	15,440,000	15,440,000	1,801,248	3,107,767	6,424,933
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	50,340,000	50,340,000	12,077,653	3,401,670	5,281,877
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	16,520,837
Donacionet vendore	0	3	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	491,159	270,401	1,583	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 16,962,574€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i ndarjeve të reja dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2022 MMPHI kishte shpenzuar 127,999,741€ apo 58% të buxhetit final, pra me një ulje prej 10% në raport me vitin paraprak. Në këtë përqindje relativisht të ulët të realizimit ka ndikuar në masë më të madhe mos-shpenzimi i fondeve të ndara nga Huamarrja dhe Klauzola e Investimeve. Në vitin 2022 nga 15,440,000€ mjete të planifikuara nga Huamarrja ishin shpenzuar vetëm 1,801,248€ apo rreth 12%, ndërsa nga 50,340,000€ të planifikuara nga Klauzola e Investimeve ishin realizuar vetëm 12,077,653€ apo 24%. Pra zbatimi i buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe shpenzimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>237,013,729</b>	<b>220,051,155</b>	<b>127,999,741</b>	<b>143,815,760</b>	<b>92,170,794</b>
Pagat dhe mëditjet	4,002,422	4,012,130	3,618,297	3,685,246	1,805,502
Mallrat dhe shërbimet	21,930,855	22,999,109	17,243,070	14,961,967	11,488,445
Komunalitë	481,490	483,490	250,641	219,050	158,304
Subvencionet dhe transferet	1,643,814	1,643,814	1,172,636	1,283,507	1,300,800
Investimet Kapitale	208,955,148	190,912,612	105,715,097	123,665,991	77,417,743

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë.


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 9,708€ dhe kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve nga fondet e përcaktuara të donatorëve në programin e “Agjencisë kosovare për mbrojtjen e mjedisit” (AKMM). Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 90%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,070,254€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje në vlerë 100,800€ dhe vendimeve për kursime në vlerë 1,050,000€. Po ashtu ishte bërë një transfer i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në këtë kategori në vlerë 1,538,000€ si dhe kishte ndarje nga fondet e donatorëve në vlerë 481,454€. Realizimi i buxhetit final ishte 75%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,643,814 dhe nuk kishte pësuar ndryshime në raport me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 71%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 18,042,536€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve qeveritare për kursime në vlerë 15,993,957€, transferim i mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë 1,538,000€ si dhe shkurtime nga MFPT në vlerë 2,190,151€. Po ashtu kishte ndarje të reja në këtë kategori me vendime Qeveritare në vlerë 1,679,572€. Shkalla e realizimit të buxhetit ishte 55%. Shkaktarët e këtij niveli jo të kënaqshëm të shpenzimit kanë të bëjnë me shtyrjen dhe mos-realizimin e projekteve të financuara nga burimet e Huamarrjes dhe Klauzolës së investimeve, mos-realizimi i projekteve ekzistuese të kontraktuara para vitit 2022 për shkak të inflacionit dhe kërkesës për rishikim të çmimeve nga operatorët ekonomik si dhe tej zgjatjes së procedurave të prokurimit për projekte të reja si rezultat i ankesave të shumta të operatorëve në OSHP.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MMPHI në vitin 2022 ishin në vlerë 4,691,164€. Të hyrat jo tatimore kryesisht kanë të bëjnë me të hyra të realizuara nga taksat e lejeve të vozitjes, licencat për transport të mallrave, të hyrat nga shfrytëzimi i ujit, licencat për shfrytëzimin e pyjeve, licenca tjera për afarizëm etj, ndërsa të hyrat tjera kanë të bëjnë me të hyrat nga kthimi i mjeteve nga vitet e mëhershme.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,483,009</b>	<b>5,483,009</b>	<b>4,691,164</b>	<b>6,107,582</b>	<b>2,952,109</b>
Të hyrat jo tatimore	5,483,009	5,483,009	4,658,223	5,929,546	2,952,109
Të hyrat tjera	0	0	32,942	178,036	


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV të vitit 2021 ka rezultuar me 25 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, shtatë (7) rekomandime ishin zbatuar, një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm më, tre (3) ishin zbatuar pjesërisht si dhe 14 rekomandime të tjera nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit si dhe pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ri-destinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi identifikuar keq-klasifikim të shpenzimeve në kategorinë Mallra dhe shërbime dhe Investime kapitale.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e këtyre të punësuarve duke siguruar	Gjendja në raport me vitin paraprak lidhur me këtë	Nuk ka filluar zbatimin

		kushte pune, duke përcaktuar objektiva të qarta të punës si dhe të siguroj monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	kategori të të punësuarve ishte e njejtë.	
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar regjistrimin e saktë dhe të plotë të të gjitha pasurive kapitale në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të pasurive (sidomos vlerave të regjistruara të shpenzimeve të mirëmbajtjes) në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e identifikuar dhe të prezantohet saktë vlera e pasurive në PVF për vitin 2022.	Janë korrigjuar regjistrimet e mirëmbajtjeve verore dhe dimërore të rrugëve por megjithatë edhe këtë vit janë identifikuar disa pasuri të paregjistruara si dhe regjistrime të gabuara të pasurive jo kapitale në SIMFK.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.	Mangësi të njejtë janë identifikuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.	Vlera e gabimeve në shpalosje është zvogëluar dukshëm këtë vit.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Edhe këtë vit shpalosja e detyrimeve kontingjente nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura për të siguruar që përmes menaxherëve të kontratave do të bëhet mbikëqyrja e duhur e realizimit të kontratave në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre. Gjithashtu, ministri duhet të siguroj përmes zyrës së prokurimit se aplikohen lloji i procedurës për kontratë kornizë duke potencuar devijimin +/-30% në vlerën indikativë të kontratës (në rastet kur mund të definohet sasia indikative), dhe vetëm në rastet kur sasia indikative nuk mund të definohet, atëherë të aplikohen kontrata me çmim njësi në formën që e parasheh ligji.	Edhe këtë vit kishte tejkalim të vlerave të kontratave.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Baza për konkluzion	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet	Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi që nuk kemi	Pjesërisht i zbatuar



		paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme. Po ashtu të sigurohet se pagesa bëhet vetëm për sasitë e realizuara dhe për rastin e identifikuar të ndërmerren masa për kthim të mjeteve.	identifikuar raste të njehta tek projektet e bashkëfinancimit.	
9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të vendos kontrolle të shtuara financiare dhe të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me përpikëri të gjitha procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen sipas rregullave të përcaktuara ligjore.	Kjo dukuri ka vazhduar të përsëritet edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që çdo shërbim i pranuar të jetë në përputhje me kushtet e kontraktuara si dhe për çdo ndryshim në kushtet e kontratës të siguroj se nuk anashkalohen kërkesat ligjore.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se kontrata kornizë aplikohen vetëm në rastet kur sasia e saktë nuk mund të definohet përderisa në rastet kur dihen saktë sasitë të aplikohen procedurat e duhura për dhënie të kontratës.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
12.	Baza për konkluzion	Ministri, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrolle efektive në fushën e prokurimit, për të siguruar vendosjen e kriterëve të qarta në dosje të tenderit në përputhje me legjislacionin përkatës dhe se vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
13.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rishikoj mekanizmat e kontrollit në sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
14.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në bashkëpunim me menaxherin e prokurimit duhet të sigurojnë që kriteret e vendosura në Dosjen e tenderit të jenë të qarta, po ashtu të sigurojnë se dëshmitë e kërkuara të mos bien në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla në procedurat e zhvilluara të prokurimit të vitit 2022.	I zbatuar
15.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në bashkëpunim me MPB-në duhet të gjej një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.	Është lidhur kontrata e re nga MPB.	I zbatuar
16.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat	Vonesat në realizimin e projekteve	Nuk ka filluar zbatimin

		parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.	vazhdojnë të jenë të theksuara.	
17.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në terren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MMPHI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.	Këto mangësi vazhdojnë të jenë evidente.	Nuk ka filluar zbatim
18.	Investimet kapitale	Ministri duhet të merr masa që të evitohen kontestet përmbarimore që lidhen me shpronësimet si dhe të sigurojë buxhet të mjaftueshëm që obligimet të paguhen brenda afateve ligjore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë të përmbarimit.	Edhe këtë vit janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
19.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
20.	Investimet kapitale	Ministri në bashkëpunim me institucionet e involvuara në këtë proces duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim nga të gjitha institucionet.	Ministria kishte formuar disa grupe punuese për ndërmarrjen e veprimeve ligjore dhe teknike për funksionalizimin dhe avancimin e Softuerit megjithatë sistemi edhe gjatë vitit 2022 nuk ishte funksional.	Nuk ka filluar zbatim
21.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.	Ky rekomandim nuk është i aplikueshëm më pasi që Udhëzimi Administrativ Nr.2008/3 është shfuqizuar me datë 23.12.2021.	Nuk është i aplikueshëm më
22.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se procesi i inventarizimit përpilohet me kohë dhe është bërë krahasimi i gjendjes së	Nuk kemi hasur mangësi të tilla këtë vit.	I zbatuar

		inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në mënyrë që të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive në PFV.		
23.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.	Edhe gjatë vitit 2022, ministria nuk kishte arritur të bëjë inkasimin e borxheve.	Nuk ka filluar zbatimin
24.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.	Edhe këtë vit gjendja është e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
25.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.	Edhe këtë vit Komiteti i Auditimit nuk ishte funksional.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli, Udhëheqëse e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA (REP. PUB. RI KOSOVO)	
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure	
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture	
Num. i dokumentit	SP-02
Num. i referencës	3455/23
Titulli i dokumentit	01
Data e miratimit	23.06.23
PRISHTINË / A No.1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Izedin Bytyri

Zv.Sekretar i Përgjithshëm i MMPPH-së

Data: 23.Qershor.2023.

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>10</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënime fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Rruga nacionale Prishtine-Gjilan-Konqul - 177,654.86€; Rehabilitimi i linjës x hekurudhore Fushë Kosovë - Hani i Elezit – 2,014,351.90€; Rehabilitimi i linjës 10 hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit) – 654,936.75€; Rehabilitimi i linjës 10 hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit) – 1,530,000€; Mirëmbajtja investive 595,371.41€.
- <sup>6</sup> Projektet e përfunduara që nuk kanë filluar të zhvlerësohen: “Hartimi i kadastrit të ujërave (sipas UA 12/2013 SIU)” në vlerë 540,000€; “Zgjerimi i rrugëve Brahim Ademi dhe Driton Islami” në vlerë 3,718,937€; “Ndërtimi i rrugës Vojnik-Osojan, Lot 2” në vlerë 997,885€; “Zgjerimi i rrugës rajonale R102, Segmenti: Komaran-Morinë, L=17.00km, Lot 2” në vlerë 3,427,339€; “Shtresimi me asfalt ne rrugën Hajkobillë (te Xhamia) – Zajqevc-Tuxhec (Novak) L=12550m” në vlerë 1,046,201€. Projektet me bashkëfinancim që nuk janë bartur në Komuna: “Ndërtimi i nënkalimit në fshatin Varosh Lot 1” (vlera neto në SIMFK 776,603€); “Asfaltimi i rrugës “Plemetin – Milloshevë, Hoxhë Ali Qerkezi- Obiliq” (vlera neto në SIMFK 100,000€); “Zgjerimi dhe ri-konstruimi i rrugës Prilep-Irzniciq” (vlera neto në SIMFK 422,002€); “Ndërtimi i rrugës Koshutan – Lekaj Rugovë” (vlera neto në SIMFK 309,790€).
- <sup>7</sup> Neni 35.3. Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rrol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimi, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.)
- <sup>8</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>9</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>10</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.